

11/03/2022

## **Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë strehon të pastrehët në shtëpi të re në bashkëpunim me dhurues dhe besimtarë**



Me iniciativën e klerikëve dhe të stafit të Zyrës së Rinisë të Kryepiskopatës së Hirshme të Tiranës, me kontributet e dhuruesve nga komuniteti i Apeldoornit, Hollandë, (VONO 2022) me përfaqësues z.Jaap Kappers, me dhurimet e dashamirësve të Zyrës së Rinisë, me bekimin dhe nën kujdesin e veçantë të Mitropolitit të Elbasanit Hirësi Andonit, me mbështetjen dhe bashkëpunimin e Kryetarit të Bashkisë të qytetit të Gramshit, z. Klodian Taçe – u bë e mundur të ndërtohet nga themelet shtëpia e re me sipërfaqe 98 m2 për një familje në nevojë prej 8 anëtarësh në këtë qytet. Shpenzimet e kësaj shtëpie arritën vlerën 28.700€, prej të cilave 22.700€ nga VONO Apeldoorn dhe 6.000€ dhuruar nga miqtë e Zyrës së Rinisë.

[Radio “Ngjallja”](#)